Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

05/Nr.3644/2026
Data:19.10.2026

PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 21.09.2026 në Sallën e Takimeve në Shtëpinë "Imri Curri". Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 11:30 prezent ishin 16 (gjashtëmbëdhjetë) qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit.

Takimin e kryesoj Drejtori i Drejtorisë për Arsim z.Hisni Luri.

Rendi i Punës

1. Propozim për ndryshimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Hisni Luri:- plotësim ndryshimi është kërkuar nga asambleja komunale dhe rregullorja është në nivel komunal nuk është vetëm për drejtorinë e arsimit, por në asamble janë dy pika që janë kërkuar për shqyrtim apo ndryshim. Ajo që është e rëndësishme për ne si drejtori me kërkesa të qytetarëve dy vite më herët e kemi bërë plotësim ndryshimin e rregullores ku është shtuar numri i subvencioneve për bursat e studentëve po ashtu është shtuar numri për përfshirjen e studentëve të cilët studiojnë në Universitetin e Tetovës. Është kërkuar komisioni për me u ndryshuar por kërkesa e auditorit ka qenë që komisioni të jetë prej pesë anëtarëve në mënyrë që të jetë më transparente , pika tjetër që kërkohet për me u ndryshuar është te neni 14.2 i cili përcakton se kategoritë dhe shumat e subvencioneve për bursa do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës, për çdo vit fiskal si dhe shumat tjera ipen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës, Kjo është bërë për një arsye që mos me proceduar dy apo më shumë herë në kuvend për një arsye shumë të thjeshtë se kemi me ndarë bursa për studentë duke u bazuar në mjetet financiare që i kemi si drejtori e arsimit. Me qenë se kërkesa e DKA-së është që të qëndrojë kështu fjalën e kalojë tek ju për debat publik.

Resul Suma:- kemi kërkuar që të bëhet ndryshimi se vitin e fundit ka pasur shumë ankesa, pra janë ankuar tre apo katër studentë dhe kemi menduar për të mirën e të gjithëve me kthyer qysh ka qenë më herët .

Mehmet Ballazhi:- a e keni arsyetuar mirë këtë. Arsyeja se pse e kemi ndërruar është se nëse janë pesëdhjetë bursa dhe mund të jenë pesëdhjetë e një që i plotësojnë kriteret dhe pesëdhjetë e njëshin si e plotësoni ju si Kuvend, pra nëse është i katërdhjetë e nënti, i pesëdhjeti dhe pesëdhjetë e njëshi me të njëjtat kritere cilit do të ja jepni bursën ju.

Resul Suma:- në bazë të pikëve.

Mehmet Ballazhi:- nëse janë me kritere dhe me pikë të njëjta, pra si do ta plotësoni ju.

Resul Suma:- kur është kërkuar me u bërë plotësim ndryshimi kemi mendu që vit pas viti me shtuar numrin për shkak se buxhetit është tu rritë.

Mehmet Ballazhi:- ju nuk mundeni me shtuar numrin e bursave nëse merret vendim për 60 a ndërsa 61 i plotësojnë kushtet dhe kriteret, si do ta shtoni numrin pra si do të jetë përfitues i bursës me të njëjtat kritere me 60.

Resul Suma:-së bashku me ju do të ndahen.

Mehmet Ballazhi:- me mu jo sepse kur e kam bërë unë nuk e kam bërë për ndonjë benifit dhe nëse e merrni ju me i zhvillu procedurat mu më lironi prej këtyre përgjegjësive. Është mirë ta diskutoni dhe ta analizoni këtë çështje kur të shkoni në kuvendë e votoni apo nuk e votoni është çështje juaj, sepse pasi të kryhet dhe pasi të vjen ligjshmëria mos e potenconi hajde pe diskutojmë.

Visar Hasallari:- si grup parlamentarë i LDK-së edhe atë ditë kur është propozuar nga z.Resul Suma nuk e kam pasur të qartë se çka është tu dashur me këtë pikë. Në kuvend u propozua komisioni dhe a mundeni me na shpjeguar se çfarë roli ka me pasur ai komision .

Resul Suma:- kohët e fundit ka pasur pakënaqësi me mënyrë se si janë ndarë bursat, pra ka pasur shumë kolegë të juve dhe të mitë që shumica janë doktor të ardhshëm të cilët kanë pasur pakënaqësi me mënyrën se si janë ndarë bursat. Në këtë rregullore komisioni ka me qenë i DKA-së i njëjti vetëm se kuvendi i komunës ka me përcaktuar se sa bursa ndahen dhe për çdo vit i caktojmë kriteret se për çka ka nevojë komuniteti jonë. Komisioni mbikëqyrës të cilin e kemi propozuar nuk ka me pasur drejtë vote por vetëm ka me mbikëqyrur punën e komisionit të cilin e përcakton DKA-ja.

Mehmet Ballazhi:- nëse jepen bursa për 50 studentë dhe kriteret i plotësojnë pesëdhjetë e një shtrohet pyetja nëse dy studentë janë me pikë të barabarta që i kanë plotësuar kriteret atëherë si do të veprojmë pra kur është ndryshuar kjo është ndryshuar për me heqë dilemën që i pesëdhjetë e ngjishi mos me mbetur pa bursë. Ndoshta kemi pasur raste që katërmbëdhjetë studentë i kemi subvencionuar, e kështu siç po potenconi nuk kemi mundur me i subvencionuar me vendim të juajin, ndërsa me vendim të kryetarit mundemi sepse e shohë sa kam buxhet. Ju merreni si përgjegjësi sepse mu ma heqni një gajle shumë të madhe.

Florim Shkreta:- kjo punë nuk mendoj që ka ndonjë farë filozofie që mundet me u bërë problematike për shkak sepse së pari shikohet se a ka buxhet drejtoria , nëse janë dhjetë mijë euro atë buxhet e vendosim se për sa studentë me ju ndarë bursa , procedohet në kuvendë dhe kuvendi e përcakton . Nuk jemi duke përcaktuar shifra dhe numër të studentëve pa i ditur mjetet financiare.

Mehmet Ballazhi:- e para është se nuk jeni duke e kuptuar esencën e kësaj zgjidhje sepse çështjen e mjeteve financiare e dimë. Nëse i kemi caktuar shumën e bursave prej tridhjetë mijë euro dhe aplikues ka për tridhjetë mijë e pesëqind euro si do të zgjidhet shuma edhe për një studentë më shumë nëse do të jenë me kritere të njëjta. Kjo është çështje e juaja a e votoni apo nuk e votoni.

Hisni Luri:- subvencionet për arsim janë katërdhjetë mijë euro që nuk do të thotë që fokusohemi vetëm te bursat sepse tash kemi me i subvencionuar prindërit me nevoja të veçanta por kjo është temë tjetër. Bursat që janë ndarë herën e fundit kanë qenë për pesëdhjetë e një studentë për shkak se dy kanë qenë me pikë të barabarta dhe ndoshta ka raste që edhe komisioni mund të gabojë siç ka gabuar më herët që ne si qeverisje ja kemi paguar. Margjina e gabimit mund të ndodhë se nuk mund të bëhemi perfekt. Nëse kërkoni me shtuar më shumë përgjegjësi jemi në rregull por te pjesa e ndarjeve të subvencioneve pasi të kalon gjithë verifikimi përmes kësaj rregullore që janë kushtet kriteret të përcaktuara në rregullore, janë drejtimet deficitare të cilat janë të përcaktuara dhe të gjitha kanë pikë dhe kur të mblidhen pikët ndoshta dikujt i dalin të barabarta dhe për pesëdhjetë apo pesëdhjetë e një pse me proceduar në Kuvend përsëri.

Florim Shkreta:-kjo çështje ndoshta është bërë për shkak se ka qenë edhe një studentë dhe ke dashur me përfshirë në listë dhe nuk them që është bërë dëm por është bërë mirë, mirëpo kur të vendoset paraprakisht janë këto mjete financiare dhe e kemi këtë numër të aplikuesve, kanë me u shikuar kriteret dhe do të vendoset numri i studentëve tridhjetë dhe e dimë që për tridhjetë persona kemi me ngritur dorën.

Resul Suma:- a ka pasur ankesa dhe a ju ka kthyer komisioni për ankesa përgjigje dhe nëse mundeni më tregoni përgjigjen prej sekretarit të UT-së

Hisni Luri:- po ankesa ka pasur dhe komisioni për ankesa i ka kthyer përgjigje. E kam ligjshmërinë ashtu siç e kemi bërë në raport për me i ndarë ato bursa, është e dokumentuar dhe e vulosur kur do mundem me ta siguruar e që është ndesh me atë që ty na i ke potencuar , ty na ke përzi me sistemin e Bolonjës që gati të gjitha universitet te na funksionojnë me sistemin e Bolonjës e që ajo e ka thënë të kundërtën, në raste se ka më shumë semestra të regjistruar se sa viti akademikë atëherë bie ndeshë dhe llogaritet përsëritës .

Mehmet Ballazhi:-për mos me diskutuar më shumë këtë sepse nuk e kemi patjetër për me bindur njëri tjetri por ju i keni duart në kuvend dhe mund të votoni si të doni dhe ju i merrni përgjegjësitë.

Bajrush Laçi:- u përmend komisioni i ankesave dhe te kjo rregullore me sa shohë është një far diskrepance dhe është mirë me parë se çka doni me ndryshuar, e ndoshta do të ishte mirë me qenë edhe një grup pak më i vogël, këto të cilët e kanë propozuar për me parë se çka duan me ndryshuar se nuk ka harmonizim siç po e shohë unë , e nëse prek diçka duhesh me prek krejt diçka tjetër në rregullore, duhet të bëhen disa ndryshime të tjera, deri më tani ka shkuar shumë mirë ndarja e bursave dhe rregulloret të cilat miratohen në kuvend e obligojnë kryetarin e komunës për me i ekzekutuar, me i implemntuar e që njëjtë ka qenë edhe kjo nuk ka pasur ndonjë problematikë. Çdo kund që të shkosh ke ankesa dhe shqyrtimi i tyre bëhet prej komisionit të ankesave të komunës dhe pastaj përcillen për gjykatë dhe nuk është mirë me potencuar që komisioni i ankesave nuk ka vendosur mirë sepse rregullorja i ka disa kritere shumë të veçanta që duhet me i shqyrtuar dhe ankesat të cilat janë kthyer janë në përputhshmëri me ligjin. Nëse dikush që e vëren që nuk është në rregull mundet me shkuar në gjykatë. Asnjë komunë nuk ka komision për mbi komision.

Mehmet Ballazhi:- duhet ta formuloni ata që po kërkoni dhe e prezantoni në kuvend pastaj varet prej kuvendit se a voton apo jo.

Hisni Luri:- A keni edhe ndonjë diskutim apo propozim, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur këtë takim. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Debati përfundoi në ora 12:15.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

Drejtori për Arsim
Hisni Luri